



VENDIM MBI PAPANUESHMËRI

Data e miratimit: 10 janar 2017

Numri i lëndës. 2015-04

Nazmi Maloku

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 10 janar 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Zj. Noora AARNIO, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, vendosi si në vijim:

I. PROCEDURA PARA PANELIT

1. Ankesa është regjistruar me 7 maj 2015. Me rastin e parashtrimit të ankesës së tij, ankuesi ka theksuar se nuk kishte vërejtje që identiteti i tij të bëhej publik.

2. Me 18 maj 2015 dhe 27 shtator 2015, ankuesi i ka dërguar Panelit informata shtesë.
3. Me 29 shtator 2015 dhe përsëri me 1 tetor 2015, ankuesi është takuar me anëtarët e Sekretariatit të Panelit.
4. Ankesa dhe informatat shtesë i janë komunikuar shefit të Misionit ("ShM") me 14 tetor 2015 dhe përkatësisht me 12 nëntor 2015.
5. Me 14 dhjetor 2015, shefi i Misionit ("ShM") i ka parashtruar Panelit vërejtjet e tij. ShM-ja ka kërkuar që disa informata që i ishin ofruar Panelit duhej të mbeteshin konfidenciale. ShM-ja i ka ofruar Panelit një version të shkurtuar, me pjesë të fshira, të parashtrësive të tij me qëllim të informimit të ankuesit dhe opinionit të gjerë lidhur me thelbin e parashtrësive të tij. Paneli ka pranuar që ankuesi nuk është dëmtuar nga fakti që ai e kishte marrë vetëm një version të përmbledhur të parashtrësive të ShM-së. Po ashtu, Paneli ka pranuar që në përgjithësi është e arsyeshme në këto rrethana që disa prej këtyre informatave të mos i jepen opinionit të gjerë. Mbi këtë bazë, ankuesit i ishte komunikuar versioni me disa pjesë të fshira i parashtrësës së ShM-së me 18 dhjetor 2015.

II. FAKTET

6. Nga informatat të cilat i ka ofruar ankuesi dalin faktet si në vijim:
 - Në ose rreth vitit 2010-2011, ankuesi kishte shkuar te prokurorët specialë të EULEX-it për t'u ankuar lidhur me një rast që kishte të bënte me gruan e tij që ndërliuhej me një rast të neglizhencës mjekësore duke dashur që të paraqesë ankesë kundër Prokurorit të Shtetit. Ai ishte informuar nga prokurori se duhej t'i përgatiste të gjitha dokumentet dhe se ata do ta kontaktonin atë. Rreth tre muaj më vonë, ai kishte vizituar prapë PSRK-në dhe i ka dhënë deklaratë EULEX-it lidhur me këtë çështje ekskluzive, siç thotë ai, të problemit mjekësor të gruas së tij. Kjo deklaratë ishte përgatitur në gjuhën angleze. Ai thotë se atij nuk i ishte dhënë kopja e deklaratës në gjuhën shqipe.
 - Disa muaj më vonë, së paku në tri raste, ai ishte kontaktuar nga zyrtarët e EULEX-it dhe kishte shkuar në PSRK që të takohej me ta. Ai pretendon se ishte pyetur lidhur me ngjarjet në Drenicë gjatë luftës, por me sa duket i ka informuar ata se ai nuk kishte asnjë informatë lidhur me këtë.
 - Në njërin prej këtyre rasteve, me sa duket në janar 2012, ai thotë se atij i kishin kërkuar që ta nënshkruajë një version të deklaratës së parë të tij në gjuhën shqipe. Për shkak se gjoja përbante të pavërteta, ai thotë se kishte refuzuar ta nënshkruante atë dhe u kishte kërkuar që të mos e kontaktonin më.

- Përkundër kësaj, ai thotë se ishte kontaktuar përsëri. Me ftesë të EULEX-it, ai thotë se ai bashkë me gruan e tij kishin shkuar që të takoheshin me zyrtarët e EULEX-it. Ai pretendon se gruas së tij i kishin thënë se ajo do të merrte ndihmën mjekësore lidhur me gjendjen e saj nëse arrinte ta bind ankuesin që të jep dëshmi kundër komandantëve të UÇK-së në rastin Drenica. Gruaja e tij kishte refuzuar kurse EULEX-i u kishte thënë që të shkonin.
- Ai pretendon se ishte kërcënuar më tutje nga zyrtarët e EULEX-it nëse nuk do ta nënshkruante deklaratën e tij.
- Më pas, dy ditë pasi që ishin arrestuar pjesëtarët e grupit Drenica, ankuesi thotë se ishte kontaktuar nga njerëz vendorë duke i thënë se ai ishte dëshmitar i shtetit dhe se emri i tij ishte përmendur në domenin publik. Si rezultat i kësaj, ai thotë se ishte frikësuar për jetën e tij.
- Në vitin 2012, ankuesi thotë se kishte shkuar te Avokati i Popullit për të diskutuar lidhur me këtë çështje dhe ai i kishte thënë që të parashtrijë ankesë në EULEX. Ankuesi thotë se Avokati i Popullit kishte refuzuar që ta merr ankesën e tij.
- Në qershor 2014, EULEX-i e kishte thirrë ankuesin përsëri dhe gjoja se i kishte thënë që, si viktimë, ai duhej të dëshmonte në rastin Drenica. Ai thotë se ai e kishte informuar një zyrtar të EULEX-it se nuk do të dëshmonte, por atij i kishte thënë një avokat privat që ta bëjë këtë ose rrezikonte të burgosej.
- Me 5 dhe 11 dhjetor 2014, ankuesi kishte dëshmuar në gjykatë. Ai ishte shpallur dëshmitar armiqësor nga gjykata e Mitrovicës pasi që kishte refuzuar të konfirmojë atë që ishte në një deklaratë për të cilën ai pretendonte se ishte e falsifikuar.
- Ankuesi ka deklaruar se atij i ishte thënë nga EULEX-i se ishte dëshmitar i mbrojtur dhe ishte sjellë në gjykatë për të dëshmuar. Ai thotë se në gjykatore ishte vendosur pranë të pandehurve dhe me mundësi që të shihej plotësisht nga galeria e publikut. Ai thotë se nuk ishin bërë kurrfarë përpjekje për ta mbrojtur identitetin e tij qoftë nga publiku apo nga të pandehurit. Ai ishte i referuar si dëshmitari C.
- Ankuesi thotë se nuk kishte marrë asnjë këshillë dhe se nuk i ishte ofruar kurrfarë mbrojtje nga EULEX-i përkundër kërkesës së tij lidhur me këtë.
- Ankuesi pretendon se ishte sulmuar në shtëpinë e tij nga sulmues të panjohur me 6 korrik 2015. PK-ja dhe EULEX-i ishin kontaktuar për ta raportuar këtë çështje. Një hetues tjetër i EULEX-it e kishte thirrur atë duke i kërkuar që t'i përshkruante sulmuesit. Ankuesi thotë se kishte kontaktuar edhe me një zyrtar tjetër policor të EULEX-it lidhur me këtë çështje.

- Ankuesi thotë se EULEX-i nuk kishte bërë diçka më shumë lidhur me sulmin dhe se frikësohej për jetën e tij dhe të gruas së tij.
7. Në përgjigje të sugjerimit se Misioni nuk i kishte marrë mjaft seriozisht kërcënimet e bëra ndaj ankuesit dhe se nuk i kishte adresuar ato, ShM-ja thekson si në vijim:
- i. Identiteti i mbrojtur i ankuesit ishte zbuluar nga vetë ankuesi kur kishte refuzuar që në këtë rast ai të përmendej si “Dëshmitari C”, kishte zbuluar identitetin e vet dhe kishte insistuar që të jepte deklaratë në gjykatë në mënyrë të hapur.
 - ii. Vlerësimi i rrezikut ishte kryer në lidhje me këtë rast, i cili i bëri prokurorët e EULEX-it të kërkonin nga gjykata masa mbrojtëse për të dhe një urdhër në lidhje me këtë. Ato ishin pranuar nga gjykata para se të tërhiqeshin pjesërisht pasi ankuesi e kishte zbuluar identitetin e tij dhe kishte kërkuar që të dëshmojë në gjykatë të hapur.
 - iii. Një hetim konfidencial lidhur me zbulimin publik të dëshmitarëve të mbrojtur ishte nisur, ndërsa në Gjykatën Themelore në Mitrovicë ishte ngritur një aktakuzë me 23 prill 2014 ndaj disa personave. Këto procedura penale ishin në proces në kohën e parashtrësive të ShM-së.
 - iv. EULEX-i po ashtu ishte duke i kryer disa veprime të caktuara para hetimore në lidhje me zbulimin e identiteteve të dëshmitarëve tjerë të mbrojtur në rastin “Drenica”.
 - v. Po ashtu është edhe një hetim penal në proces e sipër nga prokurorët e EULEX-it në lidhje me kërcënimin dhe frikësimin e dëshmitarëve në rastin “Drenica” – ku bëhet fjalë për “rreth shtatë të dyshuar”.
 - vi. ShM-ja po ashtu thekson se ishte ai, ankuesi, i cili e ka bërë publik identitetin e tij (të mbrojtur) në kontekstin e procedurave në gjykatën e Mitrovicës.

III. ANKESAT

8. Thelbi i ankesës mund të përmblihet në atë që ka të bëjë me tri kategori të ndryshme të akuzave:
- i. Thuhet se prokurorët dhe/ose hetuesit e EULEX-it e kanë falsifikuar një deklaratë që i atribuohet ankuesit, por e cila siç thotë ai, i ishte atribuuar atij në mënyrë të gabuar.
 - ii. Më tej thuhet se identiteti i tij i mbrojtur si dëshmitar në rastin “Drenica” kishte rrjedhur në publik.
 - iii. Po ashtu thuhet se ai i ishte nënshtruar në disa raste kërcënimeve, kurse në një rast edhe dhunës së rëndë fizike.

IV. LIGJI

Parashtresat nga ankuesi

9. Nga parashtresat e ankuesit nuk është plotësisht e qartë se cilat aspekte të ankesës i atribuohet Misionit nga ana e tij. Ndaj Paneli e ka shqyrtuar secilën prej tri pretendimeve kryesore të bëra nga ankuesi (shih par. 6 më sipër) sikur t'i jenë atribuar nga ana e tij tërësisht apo pjesërisht Misionit.
10. Parashtresat e ShM-së mund të përmbliidhen si në vijim. Së pari ShM-ja në përgjithësi i vë në pikëpyetje seriozitetin dhe besueshmërinë e pretendimeve të bëra nga ankuesi. Në lidhje me këtë ShM-ja vë në pah disa mospërputhje dhe kundërthënie. Më tej ai vë në pah gjetjet e Gjykatës Themelore të Mitrovicës lidhur me seriozitetin dhe besueshmërinë e ankuesit si dëshmitar në rastin "Drenica".
11. Siç është dhënë në hollësi më poshtë, në lidhje me ato pretendime për të cilat ShM-ja konsideron se kanë një bazë të caktuar, është pohuar se ato ose nuk mund t'i atribuohen Misionit ose i janë nënshtruar të gjithë hapave të domosdoshëm dhe të arsyeshëm nga ana e Misionit. ShM-ja hedh poshtë çfarëdo supozimi se të drejtat themelore të ankuesit ishin shkelur nga Misioni.
12. ShM-ja ka kontestuar supozimin se Misioni ka shkelur ndonjë prej të drejtave të ankuesit. ShM-ja ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet mbi bazën e "mospërputhshmërisë me kriteret materiale [të Rregullës 25 të Rregullores së Punës së Panelit], pasi që ankesa nuk ka të bëjë me asnjë shkelje të të drejtave të njeriut nga EULEX-i". SHM ka pohuar më tej se hetuesit dhe prokurorët e EULEX-it kishin vepruar me kujdes dhe në përputhje me obligimet e tyre ndaj të drejtave të njeriut ashtu që ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar.

Vlerësimi nga Paneli

Kriteret e përgjithshme të pranueshmërisë

13. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të përdor instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

14. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
15. Sipas Rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtoj ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX Kosova gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
16. Sipas Rregullës 25, paragrafit 3, të rregullores së vet të punës, ankuesi duhet ta parashtrojë ankesën brenda afatit gjashtë mujor nga akti, vendimi apo veprimi i cili thuhet se paraqet ose përfshin shkelje të të drejtave të tij (shih, p.sh., *Gashi kundër EULEX-it*, nr. 2013-22, 7 prill 2014, para. 10; *Thaqi kundër EULEX-it*, cituar më sipër, par. 51; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, 29 shtator 2014, par. 40 e tutje).

Falsifikimi i pretenduar i deklaratës së ankuesit

17. Nga ankuesi pretendohet se ai ishte takuar dhe ishte intervistuar nga prokurorët dhe hetuesit e EULEX-it si rezultat i të cilës nga ai ishte marrë një deklaratë. Nga dosja shihet se kjo deklaratë ishte marrë me 24 janar 2012. Deklarata rezultuese përmban informata përkitazi me krimet (e luftës) që pretendohet se janë kryer nga pjesëtarët e të ashtuquajturit grupi "Drenica". Kjo deklaratë sugjeron se ankuesi ishte dëshmitar i disa prej këtyre krimeve të pretenduara.
18. Megjithatë, ankuesi pretendon se kjo deklaratë është një fabrikim dhe se ai asnjëherë nuk kishte dhënë deklaratë në lidhje me këto çështje. Përkundrazi, ai pretendon se kishte dhënë deklaratë lidhur me një çështje që fare nuk ishte e ndërlidhur me këtë. Po ashtu ai pretendon se nënshkrimi i tij që shihej në dokument mund të jetë një falsifikim apo nënshkrimi i vërtetë i vënë në deklaratën në gjuhën angleze, të cilën ai nuk e kuptonte.
19. Siç është thënë më sipër, pasi ishte paraqitur në Gjykatën Themelore të Mitrovicës si dëshmitar në rastin "Drenica", ai ishte shpallur "dëshmitar armiqësor" nga Gjykata. Gjykata në aktgjykimin e datës 27 maj 2015 kishte vijuar më tej duke vlerësuar se ai ishte "plotësisht jo i besueshëm" si dëshmitar dhe me "tendencë për sabotim" gjatë ballafaqimit me deklaratën e tij të mëparshme. Sipas Gjykatës, "rrëfimi i tij lidhur me falsifikimin e të dhënave të intervistës së tij të procedurës paraprake ishte naiv dhe jo bindës".
20. Si çështje paraprake, Paneli vlerëson se procesi i kontestuar i marrjes së deklaratës kishte ndodhur në janar 2012 dhe se përkthimi në gjuhën shqipe i ishte dhënë ankuesit rreth katër muaj më vonë me çka do të duhej që ai të kishte vërejtur çfarëdo mospërputhje në mes të dëshmisë së tij dhe asaj që ishte shkruar. Si e tillë, çfarëdo shkelje e

të drejtave që del nga ai proces do të binte jashtë kriterit të afatit 6-mujor të Panelit.

21. Edhe po që se supozohet se ankuesi kishte marrë vesh më vonë lidhur me ndryshimin apo falsifikimin e pretenduar të deklaratës së tij, duket sikur ka pak bazë në pretendimin e tij se prokurorët e EULEX-it e kanë fabrikuar një deklaratë të tërë lidhur me çështjet për të cilat ai tani pretendon se nuk di asgjë rreth tyre dhe se ata e kishin falsifikuar nënshkrimin e tij. Duke i marrë parasysh dyshimet e ngritura nga Gjykata Themelore e Mitrovicës lidhur me seriozitetin dhe besueshmërinë e dëshmisë së tij, si dhe duke marrë parasysh gjithashtu se Gjykata Themelore e kishte pasur mundësinë që ta dëgjojë atë, Paneli e ka trajtuar dëshminë e tij me kujdes.
22. Prandaj, kjo pjesë e ankesës është e papranueshme, pasi është e pabazuar.

Zbulimi publik i identitetit të ankuesit si dëshmitar i mbrojtur

23. Siç është theksuar më sipër, ankuesi gjithashtu në ankesën (dhe komunikimet e mëpastajshme) të tij i referohet faktit se identiteti i tij si dëshmitar i mbrojtur (Dëshmitari C) në rastin Drenica ishte bërë publik. Nga parashtrësit e tij nuk është e qartë nëse ai këtë fakt ia atribuon EULEX-it apo çfarë dëmi, thotë ai, do t'i ketë shkaktuar atij.
24. Në lidhje me këtë, Paneli fillimisht e përsërit rëndësinë e madhe të dëshmitarëve për funksionimin e sistemit të drejtësisë penale (në përgjithësi shih Këshillin e Evropës, Rekomandimin e Këshillit të Ministrave Rec (2005)9 i Këshillit të Ministrave për vendet anëtare për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, 20 prill 2005).
25. Në mënyrë që dëshmitarët dhe “bashkëpunëtorët e tjerë të drejtësisë” t'i kontribuojnë atij sistemi, të drejtat themelore të tyre duhet të mbrohen në mënyrë të duhur ashtu që përfshirja e tyre në këtë proces të mos i ekspozojë ata ndaj asnjë rreziku apo dëmi. Prandaj Paneli e nënvizon se sa është e rëndësishme për autoritetet kompetente hetimore dhe të prokurorisë që të sigurojnë që dëshmitarët në rastet penale dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë të mbrohen nga dëmi dhe nga pasojat të tjera negative që dalin nga përfshirja e tyre në procedurat gjyqësore. Në lëndën *W*, Paneli ka theksuar se përgjegjësia e autoriteteve për mbrojtjen e dëshmitarëve në disa raste mund të nënkuptojë detyrim pozitiv nga ana e tyre për të marrë masa për të siguruar mbrojtjen dhe sigurinë e dëshmitarëve edhe pse ky detyrim nuk duhet të imponoj ndonjë barrë të pamundur apo joproporcionale mbi ta (*W kundër EULEX-it*, 2011-07, 10 prill 2013, par. 48).
26. Një aspekt veçanërisht i rëndësishëm i kësaj mbrojtjeje ka të bëjë me mbrojtjen e identitetit të dëshmitarëve të ndjeshëm, të cilët janë pjesë

e masave mbrojtëse dhe të cilët mund të jenë në rrezik të dëmtohen nëse identiteti i tyre zbulohet në publik. (ibid, par. 49, 52-53; shih gjithashtu *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 72).

27. Në këtë rast të veçantë, nuk ekziston ndonjë tregues se ishte EULEX-i ai që e bëri publik identitetin e ankuesit. Përkundrazi, nga shënimet e procedurave në gjykatën e Mitrovicës është e qartë se ishte vetë ai që e kishte bërë publik identitetin e vet dhe kishte kërkuar që të dëshmojë pa masa mbrojtëse (shih më sipër par. 7). Në këto rrethana, sugjerimi se EULEX-i ka shkelur të drejtat e tij – të sigurisë dhe privatësisë – duke e bërë publik identitetin e tij nuk kanë bazë dhe janë të pabazuara.

Kërcënimet e bëra ndaj ankuesit apo familjes së tij

28. Aspekti i tretë dhe i fundit i ankesës ka të bëjë me kërcënimet dhe aktet e dhunës, të cilat ankuesi thotë se ishin drejtuar ndaj tij apo të afërmeve të tij.
29. Në përputhje me rregullën e afatit 6 mujor të përmendur më sipër (shih par. 16 më lartë), Paneli do t'i shqyrtojë vetëm ato pretendime të cilat nuk janë më të vjetra se gjashtë muaj para paraqitjes së ankesës. Gjithashtu, Paneli ka vendosur që, "proprio motu", t'i shqyrtojë pretendimet për kërcënimet dhe dhunë që kanë ndodhur pas paraqitjes së ankesës në Panel. Ai i konsideron këto pretendime si plotësimet efektive të ankesës së paraqitur me 7 maj 2015.
30. Paneli fillimisht vlerëson se ankuesi nuk pohon se secila prej këtyre kërcënimeve apo akteve të dhunës mund t'i atribuohen Misionit apo ndonjërit prej pjesëtarëve të tij. Prandaj, ankesa duket se ka të bëjë me sugjerimin se EULEX-i nuk ka bërë mjaft për t'i hetuar ato.
31. Pasi i ka shqyrtuar në mënyrë të kujdesshme hapat e ndërmarra nga Misioni (shih më lartë), dhe në bazë të të gjitha rrethanave përkatëse, Paneli ka ardhur në përfundimin se Misioni ka vepruar në mënyrë të kujdesshme duke u përpjekur që ta mbrojë dëshmitarin dhe në përpjekjet për t'i garantuar të drejtat themelore të tij (shih më sipër, par. 25). Kjo detyrë ishte bërë veçanërisht sfiduese nga veprimet e vetë ankuesit (veçmas, zbulimi i identitetit të tij nga vetë ai; kontaktet e tij me palët në procedurë; ndërrimet e ndryshme të qëndrimeve të tij lidhur me Misionin). Derisa Misioni ka përgjegjësinë përfundimtare për t'i garantuar të drejtat themelore të atyre me të cilët bashkëvepron, ai nuk mund të fajësohet për mos adresimin e rrethanave që nuk janë në kontrollin e tij.
32. Posaçërisht lidhur me sulmin ndaj ankuesit që thuhet se kishte ndodhur në shtëpinë e tij me 6 korrik 2015, ShM-ja hotë si në vijim:
- i. Ai është në dijeni për këtë pohim, pasi që ankuesi i kishte informuar hetuesit e NJHKL-në lidhur me të.

- ii. Ai tërheq vëmendjen Panelit në mospërputhjet faktike të versionit(eve) për këto ngjarje të dhenë nga ankuesi.
- iii. Ai thekson faktin se ky incident kishte ndodhur në një banesë që thuhet se i ishte dhuruar ankuesit nga të pandehurit në rastin "Drenica".
- iv. Hetuesi i EULEX-it që ishte marrë me këtë çështje e kishte këshilluar ankuesin që ta raportonte këtë rast në Policinë e Kosovës si autoritet kompetent për këtë çështje. ShM-ja tërheq vëmendjen në faktin se raporti i zyrtarit (të Policisë së Kosovës) përgjegjës për çështjen kishte ngritur "dyshime të arsyeshme dhe të bazuara për të besuar se [ankuesi] nuk po e tregonte të vërtetën apo po gënjente".

Mbi këtë bazë, Sh-M-ja pohon se hetuesit dhe prokurorët e EULEX-it kishin vepruar me kujdes dhe në përputhje të plotë me obligimet e tyre për të drejtat e njeriut.

33. Pasi i ka shqyrtuar të gjitha rrethanat përkatëse, Paneli pranon se drejtimi i ndjekur nga Misioni për t'i adresuar kërcënimet dhe aktet e dhunës ishte i arsyeshëm dhe në përputhje me obligimet e përgjithshme të tij ndaj të drejtave të njeriut. Në këto rrethana nuk ishte e paarsyeshme që të supozohet se autoritetet kosovare ishin në gjendje ta hetonin këtë incident të caktuar (meqë ato me sa duket e kishin bërë këtë). Nëse ankuesi është i pakënaqur me qasjen e ndjekur nga Policia e Kosovës, ai duhet të kërkojë zbatimin e masave korrigjuese të cilat ekzistojnë në kuadër të rendit juridik kosovar. Nuk është treguar nga ankuesi se vendimi i EULEX-it për të mos e hetuar këtë çështje vetë ishte arbitrar apo se nuk i kishte përmbushur obligimet e tij ndaj të drejtave të njeriut.

34. Prandaj kjo pjesë e ankesës është e papranueshme dhe e pabazuar.

Pohimet e bëra në lidhje me ankesën pranë Panelit

- 35. Me 18 tetor 2015, Paneli ka pranuar informata tjera nga ankuesi. Ankuesi ka pohuar se kishte marrë një thirrje telefonike nga hetuesi i EULEX-it me 15 tetor 2015 gjatë së cilës ajo thuhet t'i ketë thënë ankuesit se EULEX-i nuk do të merrej me rastin e tij për shkak se ai kishte parashtruar ankesë në Panel dhe se ai e kishte incizuar atë bisedë. Ankuesi nuk e ka paraqitur atë incizim.
- 36. Me 12 nëntor 2015, Paneli e kishte bërë ftuar ShM-në që ta adresonte këtë pretendim.
- 37. ShM-ja e kishte bërë këtë si pjesë të vërejtjeve të veta të datës 15 dhjetor 2015. ShM-ja nuk e ka kontestuar ekzistimin e bisedës telefonike ndërmjet ankuesit dhe hetuesit të EULEX-it. Mirëpo, ShM-ja pohon se ankuesi "po ashtu i ka shtrembëruar faktet". Sipas SHM-së, ishte ankuesi ai i cili e kishte thirr Misionin atë ditë dhe kishte kërkuar që të paraqitej si dëshmitar në një rast të caktuar që mbahej atë ditë.

ShM-ja ka sqaruar se ishte marrë qëndrim që hetuesi në fjalë të mos merrej më me ankuesin pasi që ai e kishte përmendur atë me emër në ankesën e tij. Prandaj, ankuesi ishte informuar nga hetuesi. Po ashtu, ankuesit i ishte thënë që të kontaktonte me ndonjë hetues tjetër të NJHKL-në dhe ishte informuar që ai mund të kontaktohej nga ndonjë hetues tjetër në lidhje me kërkesën e tij për t'u paraqitur si dëshmitar. Sipas ShM-së, ankuesi "po e shfaqte zhgënjimin e tij dhe kishte kërcënuar se do të bënte më shumë ankesa pasi që ndjehej i braktisur nga të gjithë".

38. Paneli e merr shumë seriozisht sugjerimin se kushdo që parashton ankesë në Panel mund të dëmtohet si rezultat i kësaj. Megjithatë, në këtë rast, në mungesë të vërtetimit të pretendimeve të ankuesit për këtë pikë dhe në bazë të refuzimit të qartë të këtyre pretendimeve nga ana e Misionit, Paneli nuk është i bindur se ankuesi e ka paraqitur të vërtetën në pretendimin e tij.
39. Prandaj, Paneli gjen se ky aspekt i ankesës nuk është vërtetuar në mënyrë të mjaftueshme. Prandaj Paneli nuk ka nevojë të vendos nëse ky akt bën pjesë në kuadër të kompetencave të Panelit apo nëse ai paraqet shkelje të të drejtave themelore.
40. Prandaj, kjo pjesë e ankesës është e papranueshme, pasi që është e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se, në pajtim me Rregullën 29(1)(c), (d) dhe (e), kjo ankesë nuk është në përputhje me Rregullën 25(3) të Rregullores së Punës së Panelit, si dhe në disa aspekte është e pabazuar apo nuk ka të bëjë me veprime që i ngarkohen Misionit ose ndonjërit prej organeve të tij, prandaj

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese